

**STATUTI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“TAKE A TAXI” SH.P.K**

**Kapitulli I**

**EMRI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

**Neni 1 – Forma**

- 1) Shoqëria “TAKE A TAXI” SH.P.K është krijuar me mjetet monetare në pronësi të themeluesve të saj:
- a) *Z. Altin Labi, lindur në Gjirokaster në datë 14.11.1970 dhe banues në Gjirokaster, me Adresën "Rruga Studenti, Nd. 10, Hyrja 4, Apartamenti 15, Gjirokaster", me shtetësi shqiptare, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i ID Nr H01114016W.*
  - b) Shoqëria vepron sipas ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
  - c) Shoqëria ka vulën e saj zyrtare.

**Neni 2 – Emri**

- a) Emri i Shoqërisë është: “TAKE A TAXI” SH.P.K

**Neni 3 – Objekti**

- Shoqëria ka per objekt, ne perputhje me kerkesat ligjore, veprimtarite e me poshtme:  
**Sherbim transport udhetaresh brenda vendit, taxi 4+1.**
- Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të marrë direkt ose indirekt interesa, në shoqëri, firma, agjensi dhe ndërmarrje të tjera, të cilat mund të kenë edhe qëllime të tjera aktiviteti.

**Neni 4 – Selia**

- a) Selia zyrtare e shoqërisë është në adresën: “*Rruga Hamdi Sina, Kompleksi FZ Constructions, Ap. 28, KP 1011 Sauk, Tirane* “.

**Neni 5 – Kohëzgjatja**

- a) Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë është e pa kufizuar.



- b) Shoqëria mund të përfundojë apo vihet në likuidim përpara këtij afati me vendim të asamblesë së ortakëve.

#### **Neni 6 – Përgjegjësitë**

- a) Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti.
- b) Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortaket në emrat e tyre personal ndaj personave të tretë.

### **Kapitulli II**

#### **KAPITALI I SHOQËRISË**

##### **Neni 7 – Kapitali**

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë “TAKE A TAXI” SHPK është 10.000 (dhjete mijë) lekë

##### **Neni 8 – Kuotat e kapitalit dhe zotërimi i tyre**

1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10,000 Lekë (dhjete mijë) ne një kuote . Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku Z. **Altin Labi**, Zoterues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 10,000 (dhjete mijë) Lekë që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë

##### **Neni 9 – Zmadhimi i kapitalit**

- a) Ortaket mund të rrisin pa kufi kapitalin e shoqërisë.
- b) Ortaket njoftojnë për regjistrim, pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit, vendimin për zmadhimin e kapitalit. Vendimi publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.
- c) Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij, në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

- d) Pas miratimit të pasqyrave financiare të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme vendos edhe për fitimet e realizuara. Asambleja mund të vendosë që me këto fitime të zmadhojë kapitalin e regjistruar, të rrisi rezervat statutore ose të shpërndajë divident.
- e) Nëasnje rast nuk mund të rritet kapitali i shoqërisë pa mbuluar më parë humbjet e rezultuara në pasqyrat financiare.

#### **Neni 10 – Krijimi i rezervave**

- a) Mbës miratimit të pasqyrave financiare, asamblea krijon rezerva statutore sipas ligjit. Kur këto rezerva të kapin shumën sa 10% të kapitalit themeltar, asamblea e ortakëve mund të mos krijojë më rezerva.

#### **Neni 11 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

- a) Ortaku mund të reduktojë kapitalin themeltar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të reduktohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- b) Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratorët. Ky vendim publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

#### **Neni 12 – Transferimi i kuotave të kapitalit**

- a) Kuotat e kapitalit mund t'u transferohen lirisht të tretëve, tërësisht ose pjesërisht me vendim të Asamblesë së ortakëve dhe me të drejtë parablerje.

#### **Neni 13 - Pasojat e kalimit të kuotave**

- a) Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë, për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

### **Kapitulli III**

#### **ORTAKËT, ADMINISTRIMI, KONTROLI**

#### **Neni 14 – Të drejtat dhe detyrimet**

1. Ortakët janë përgjegjës për marrjen e vendimeve për Shoqërinë lidhur me çështjet e mëposhtme:
  - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
  - b) Ndryshimet e statutit;
  - c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve

- d) Emërimin, shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike
- f) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- i) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j) Përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- k) Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë
- l) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

#### **Neni 15 - Procesverbalet**

- a) Të gjitha vendimet e ortakeve regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të shoqërisë.

#### **Neni 16 - Hetimet e posaçme**

- a) Ortakët mund të vendosin nisjen e një hetimi të posaçëm, për parregullsitë përgjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 91 të Ligjit Nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

#### **Neni 17 -Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshpërblimi**


- a) Ortakët kanë të drejtë t'i kërkojnë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 92 të Ligjit Nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

#### **Neni 18 – Administrimi**

Shoqëria administrohet nga administratorët. Ortakët emërojnë një ose më shumë persona fizikë si administratorë. Duke filluar nga data e miratimit të këtij statuti, administrator i vetëm i shoqërisë “**TAKE A TAXI** SHPK

do të jetë **Z. Altin Labi, lindur në Gjirokaster në datë 14.11.1970 dhe banues në Gjirokaster, me Adresën "Rruga Studenti, Nd. 10, Hyrja 4, Apartamenti 15, Gjirokaster", me shtetësi shqiptare, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i ID Nr H01114016W.**

A. Administratori emerohet me një afat 5 vjeçar.



B. Administratori ka të drejtë e detyrohen të:

- a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortakët.
- b) Përfaqësojnë Shoqërinë.
- c) Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë
- d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpala ortakeve për miratim;
- e) Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë.
- f) Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- g) Raportojnë përpala ortakeve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë
- h) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

C. Ortakët mund të zëvendësojnë administratorin në çdo kohë.

#### **Neni 19 - Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia**

- a) Administratorët detyrohen të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërsi. Administratorët përgjigjen ndaj Shoqërisë për çdo veprim që vjen në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale.

## **Kapitulli IV**

### **SHPËRNDARJA E FITIMIT**

#### **Neni 20 - Shpërndarja e fitimeve**

- a) Ortaket kane të drejtë të marrin pjesën e fitimit të dekluaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

## **Kapitulli V**

### **SHPËRBËRJE E SHOQËRISË**

#### **Neni 21 - Shkaqet e prishjes së shoqërisë**

A. Shoqëria prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakeve
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk kryen veprimtari tregtare për tre vjet
- d) me vendim të gjykatës;

Ky statut hartohej në 2 kopje në gjuhën shqipe.

Tirane, me 02.10.2023

Lexuar, nënshkruar

*ORTAKET  
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“TAKE A TAXI” SH.P.K*

Z. Altin Labi

